



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

KONTRATË

PJESA I. E KONTRATËS:

KOMUNA E DEÇANIT		MUNICIPALITY OF DEÇANI	
Nr. i Prokurimit: 631 10 099 121		Nr. i Prokurimit: 02-811	
Data e nënshkrimit: 12		Data e nënshkrimit: 06/10/10	
Emri i Prokurimit: ...		Emri i Prokurimit: ...	

Komuna e Deçanit – sheshi "M.Tolaj", në tekstin e më tejme ("Autoriteti Kontraktues"), dhe NQDN "Kosova Petrol" Deçan, që e përfaqëson Isuf Sadikaj ("Kontraktuesi") janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS: Furnizim me karburante (derivate të naftës) për nevoja të KK Deçan, QMF "Adem Ukëhaxhaj", shkolla dhe Qendra për punë sociale në Deçan

Numri i Prokurimit: 631 10 099 121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës duhet të jetë furnizimi me karburante (derivate të naftës) për nevoja KK Deçan, QMF "A.Ukëhaxhaj", shkolla dhe Qendra për punë sociale në Deçan.

1.2 Kontraktuesi furnizimin duhet ta ben në pajtushmeri të plotë me specifikim teknik të dosjes të tenderit, me kërkesë të parashtruar nga Autoriteti kontraktues;

1.3 Vendi i pranimi të mallrave duhet të jetë Komuna Deçan

1.4 Kjo është kontratë një vjeçare, dhe është e vlefshme prej ditës së nënshkrimit të saj nga të dy palët me dt. 30.09.2010 deri me dt. 30.09.2011.

1.5 Vendi i pranimi të furnizimeve do të jetë Komuna e Deçanit, afatet kohore për dërgesën do të jenë menjher pas kërkesës.

Neni 2 Origjina

1.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

1.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi furnizimit do të jetë për njësi , pagesa behët nëbazë tëçmimit te burses ndërsa Premiumi për njësi (litër derivat) 0.085 €.
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve (përveq çmimit të atyre artikujve që u nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).
- 3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta (Nenet prej 26 deri 28).

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
 Kushtet e Veçanta, përfshirë edhe aneksin teknik; (Aneksi II: saktësimet teknike-Pjesa 1;
 Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe anekset (Aneksi II: saktësimet teknike-Pjesa 2);
 Oferta financiare (Aneksi III);
 Kushtet e Përgjithshme (Aneksi I);
 [dispozita tjera të dosjes së tenderit.]

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e Veçanta.

E hartuar në gjuhën shqipe¹ tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Xhevdet Ramosaj	Emri:	Isuf Sadikaj
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Emri	Rasim Selmanaj	Data:	01/10/2010
Pozita	Kryetar i Komunës		
Nënshkrimi			
Data	01/10/2010		

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

PËR KONTRATAT E FURNIZIMIT TË FINANCUARA NGA BUXHETI I KONSOLIDUAR I KOSOVËS DISPOZITAT PRELIMINARE

Neni 1 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 Kushtet e veçanta e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e procedurës.

Neni 3 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

- 3.1 Përveç nëse është dhënë ndryshe në Kushtet e veçanta, kontrata përbëhet nga këto dokumente, të renditura sipas përparësisë:
- a) marrëveshja e kontratës;
 - b) Kushtet e veçanta me aneksin teknik;
 - c) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë anekset;
 - d) Specifikimet financiare (Aneksi III) ;
 - e) kushtet e përgjithshme (Aneksi I);
 - f) [procesverbali i takimit informues/vizitës në vend];
- 3.2. Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën do të konsiderohen se shpjegojnë njëra tjetrën, në rastet e paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit në të cilin janë paraqitur më sipër.

Neni 4 Komunikimet

- 4.1 Komunikimet ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër, do të jenë ekskluzivisht në formë të shkruar. Përveç nëse saktësohet ndryshe në Kushtet e veçanta, komunikimet ndërmjet Autoritetit kontraktues nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër, do të dërgohen me postë, faks, e-mail , ose të dorëzohen personalisht sipas nenit 4 në Kushtet e veçanta.

Neni 5 Transferimi

- 5.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 5.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

Neni 6 Nën-kontraktimi

- 6.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.
- 6.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 5 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.
- 6.3 Nënkontraktuesit duhet t'i përmbushin kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie të

kontratës, si dhe kriteret tjera të specifikuara në dosjen e tenderit që janë të nevojshme për ekzekutimin e nënkontratës.

- 6.4 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 7 Dhënia e dokumenteve

- 7.1 Nëse është e nevojshme, brenda [30] ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimi final të saj, Kontraktuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.
- 7.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

Neni 8 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

- 8.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të vendit ku do të jepen furnizimet dhe të cilat mund të ndikojnë te kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Kontraktuesi me shpenzime të Kontraktuesit.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 9 Obligimet e përgjithshme

- 9.1 Kontraktuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend, ngritjen, testimin dhe komisionimin e furnizimeve dhe realizimin e punëve tjera duke përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime. Kontraktuesi do të sigurojë edhe pajisjet, mbikëqyrjen, punën dhe lehtësirat e duhura për realizimin e kontratës.
- 9.2 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda [30] ditësh pas pranimi të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

Neni 10 Prejardhja

- 10.3 Kontraktuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes së furnizimeve në momentin e pranimi të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 11 Siguria e ekzekutimit

- 11.1 Nuk aplikohet

Neni 12 Sigurimi

- 12.1 Mund të kërkohet polisa e sigurimit për të mbuluar bartjen e furnizimeve; kushtet e kësaj polise të sigurimit mund të saktësohen në Nenin 12 të Kushteve të veçanta, ku mund të saktësohen edhe lloje tjera të sigurimit që do t'i marrë Kontraktuesi.

Neni 14 Skicat e Kontraktuesit

- 14.1 Nuk aplikohet.

Neni 15

Mjaftueshmëria e çmimeve të tenderit

15.1 Nën dispozitat që mund të paraqiten në Kushtet e veçanta, Kontraktuesi do të konsiderohet se është i kënaqur para se ta dorëzojë tenderin e tij për sa i përket saktësisë dhe mjaftueshmërisë së ofertës dhe që ka marrë parasysh të gjitha që kërkohen për realizim të plotë dhe të duhur të kontratës, dhe që ka përfshirë në normat dhe çmimet e tij të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me furnizimet, veçanërisht:

- a) Koston e transportit;
- b) Koston e mbikëqyrjes, paketimit, ngarkimit, shkarkimit, tranzitit, dorëzimit, shpaktimit, kontrollimit, sigurimit dhe kosto tjera administrative lidhur me furnizimet. Paketimi do të jetë pronë e Autoritetit kontraktues përveç nëse parashihet ndryshe në Kushtet e veçanta;
- c) Koston e dokumenteve që kanë të bëjnë me furnizimet në rastet kur këto dokumente kërkohen nga Autoriteti kontraktues;
- d) Realizimin dhe mbikëqyrjen e montimin në vendin e duhur dhe/ose komisionimin e furnizimeve të dorëzuara;
- e) Furnizimin me veglat e nevojshme për montim dhe/ose mirëmbajtje të furnizimeve të dorëzuara;
- f) Furnizimin me manuale detaje të operimit dhe të mirëmbajtjes së secilës njësi të furnizimeve, siç është specifikuar në kontratë;
- g) Mbikëqyrjen ose mirëmbajtjen dhe/ose riparimin e furnizimeve, për një periudhë kohore të dhënë në kontratë, duke paraparë që këto shërbime nuk do ta lirojnë Kontraktuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës;
- h) Trajnimin e personelit të Autoritetit kontraktues, në fabrikën e Kontraktuesit dhe/ose diku tjetër siç është specifikuar në kontratë.

15.2 Pasi që Kontraktuesi konsiderohet se ka përcaktuar çmimet e tij në bazë të llogaritjeve të veta, në operime dhe vlerësime, ai, pa pagesë plotësuese, do të realizojë punët që janë subjekt i ndonjë pike në ofertën e tij për të cilin ai nuk tregon as çmimin për njësi dhe as shumën e plotë.

Neni 16

Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

- 16.1 Që furnizimet të importohen në vendin e Autoritetit kontraktues, duhet të përfshihen të gjitha pagesat dhe tatimet e zbatueshme për importimin e tyre, duke përfshirë edhe TVSH.
- 16.2 [Cilado qoftë prejardhja e mallit të furnizuar, kontrata do të çlirohet nga detyrimet mbi vulën dhe regjistrimin.]

Neni 17

Patentat dhe licencat

17.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në Kushtet e veçanta, Kontraktuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

FILLIMI I EKZEKUTIMIT DHE VONESAT

Neni 18 Rendi i fillimit

- 18.1 Autoriteti kontraktues do ta fiksojë datën në të cilën do të fillojë realizimi i kontratës dhe ta lajmërojë Kontraktuesin për këtë ose në njoftimin e dhënies së kontratës ose përmes urdhrin administrativ që lëshohet nga autoriteti kontraktues.
- 18.2 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, realizimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se [90] ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Kontraktuesi do të ketë të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Kontraktuesit do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda [30] ditësh pas skadimit të periudhës [90]-ditore.

Neni 19 Periudha e ekzekutimit të detyrave

19.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 18 dhe do të jetë siç është thënë në kontratë, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 20.

Neni 20 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

20.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet,

Neni 21 Vonesat e ekzekutimit

21.1 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës.

21.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 21.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës.

Neni 22 Variacionet

22.1 Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasi të parapara në Kushtet e veçanta. Vlera totale e furnizimeve mund të mos rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se [10 %] të çmimit të kontratës. Çmimet e njësisë që janë përdorur në ofertë do të zbatohen edhe për sasi të prokuruar me variacion.

Neni 23 Suspendimi

23.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Kontraktuesin që të pezullojë:

- a) prodhimin e furnizimeve;
- b) dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimin në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c) instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimin. Kontraktues.

MATERIALET DHE MJESHTËRIA

Neni 24 Cilësia e furnizimeve

24.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

24.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në Kushtet e veçanta duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga kontraktuesi për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkuorohen në furnizime.

Neni 25 Inspektimi dhe testimi

25.1 Kontraktuesi do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimin me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Kontraktuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

PAGESAT

Neni 26 Parime të përgjithshme

26.1 Pagesat do të bëhen në euro. Në Kushtet e veçanta do të paraqiten kushtet administrative ose teknike lidhur me pagesat e paradhënies, pagesat e ndërmjetme dhe/ose pagesat përfundimtare që bëhen në pajtim me Kushtet e veçanta.

- 26.2 Pagesat që duhet të bëhen nga Autoriteti kontraktues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në formularin për identifikim financiar që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.
- 26.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se [30] ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës i specifikuar në Kushtet e veçanta. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.
- 26.5 Pagesat , do të bëhen si në vijim:
- 26.8 Obligimet për pagesë të Autoritetit kontraktues sipas kësaj kontrate do të ndërpriten më së shumti pas [18] muajsh pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit të detyrave, përveç nëse kontrata përfundon në pajtim me këto Kushte të përgjithshme.
- 26.9 Përveç nëse parashihet ndryshe në Kushtet e veçanta, kontrata do të jetë me çmime fikse, dhe çmimet nuk do të rishikohen, në përjashtim të çmimeve që i nënshtrohen ndryshimeve në bersën përkatëse të artikujve.

Neni 28 Vonesa e pagesës

- 28.1 Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda 30 ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, në pajtim me Nenin 43 të këtyre Kushteve të përgjithshme. Kjo periudhë kohe do të fillojë të llogaritet nga momenti i aprovimit të këtyre dokumenteve nga departamenti kompetent i përmendur në Nenin 43 të Kushteve të veçanta. Këto dokumente do të aprovohen ose në mënyrë të hapur ose të heshtur, në mungesë të reagimeve me shkrim në [30] ditë pas pranimit të tyre të shoqëruar me dokumentet e kërkuara.

PRANIMI DHE MIRËMBAJTJA

Neni 29 Dorëzimi

- 29.1 Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Kontraktuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

Neni 30 Operacionet e verifikimit

- 30.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Kontraktuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.
- 30.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

Neni 31 Pranimi i përkohshëm

- 31.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

Neni 32 Obligimet për garanci

- 32.1 Kontraktuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Për më tepër, kontraktuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria, përveç deri në atë masë sa dizajni dhe materialet të kërkohen në specifikime, ose nga ndonjë veprim apo mosveprim, që mund të shkaktohet gjatë përdorimit të furnizimeve në kushtet që zbatohen në shtetin e Autoritetit kontraktues. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në Kushtet e veçanta.
- 32.2 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- 26.2 Pagesat që duhet të bëhen nga Autoriteti kontraktues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në formularin për identifikim financiar që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.
- 26.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se [30] ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës i specifikuar në Kushtet e veçanta. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.
- 26.5 Pagesat , do të bëhen si në vijim:
- 26.8 Obligimet për pagesë të Autoritetit kontraktues sipas kësaj kontrate do të ndërpriten më së shumti pas [18] muajsh pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit të detyrave, përveç nëse kontrata përfundon në pajtim me këto Kushte të përgjithshme.
- 26.9 Përveç nëse parashihet ndryshe në Kushtet e veçanta, kontrata do të jetë me çmime fikse, dhe çmimet nuk do të rishikohen, në përjashtim të çmimeve që i nënshtrohen ndryshimeve në borsën përkatëse të artikujve.

Neni 28 Vonesa e pagesës

- 28.1 Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda 30 ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, në pajtim me Nenin 43 të këtyre Kushteve të përgjithshme. Kjo periudhë kohe do të fillojë të llogaritet nga momenti i aprovimit të këtyre dokumenteve nga departamenti kompetent i përmendur në Nenin 43 të Kushteve të veçanta. Këto dokumente do të aprovohen ose në mënyrë të hapur ose të heshtur, në mungesë të reagimeve me shkrim në [30] ditë pas pranimit të tyre të shoqëruar me dokumentet e kërkuara.

PRANIMI DHE MIRËMBAJTJA

Neni 29 Dorëzimi

- 29.1 Kontraktuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Kontraktuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

Neni 30 Operacionet e verifikimit

- 30.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Kontraktuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.
- 30.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

Neni 31 Pranimi i përkohshëm

- 31.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

Neni 32 Obligimet për garanci

- 32.1 Kontraktuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Për më tepër, kontraktuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria, përveç deri në atë masë sa dizajni dhe materialet të kërkohen në specifikime, ose nga ndonjë veprim apo mosveprim, që mund të shkaktohet gjatë përdorimit të furnizimeve në kushtet që zbatohen në shtetin e Autoritetit kontraktues. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në Kushtet e veçanta.
- 32.2 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- c) Kontraktuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

36.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Kontraktuesit. Detyrimi i Kontraktuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

Neni 37 Ndërprerja nga ana e Kontraktuesit

37.1 Kontraktuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Kontraktuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit të dhënë në Kushtet e veçanta;
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se [180] ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Kontraktuesit.

37.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit.

37.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Kontraktuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Kontraktuesit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit të dhënies ose datës kur kontrata hyn në fuqi, cilado që të jetë më herët.

Neni 39 Vdekja

39.1 Në rast se Kontraktuesi është person fizik, kontrata ndërpritet automatikisht nëse ai person vdes. Megjithatë, Autoriteti kontraktues do t'i kontrollojë propozimet e bëra nga trashëgimtarët e përfituesve nëse ata kanë shprehur dëshirën e tyre për ta vazhduar kontratën. Vendimi i Autoritetit kontraktues do t'i përcillet personave përkatës brenda [30] ditësh pas pranimit të propozimit të tillë.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 40 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

40.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda [15] ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë [30] ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrë.

Neni 41 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda [30] ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi
- b) ose vendim arbitrimi

në pajtim me Kushtet e veçanta të kësaj kontrate.

- 42.10 Organi i Shqyrtimit të Prokurimit** ka të drejtë të suspendojë ose anulojë kontratën nëse zbulohen praktika të korruptuara të çfarëdo lloji në cilëndo fazë të procesit të dhënies së kontratës dhe nëse Autoriteti kontraktues nuk i merr të gjitha masat e duhura për të përmirësuar situatën. Për qëllime të kësaj dispozite, "praktika korruptuese" janë ofrimi i ryshfetit, dhuratave, shpërblimeve në para ose "dhënies me përqindje" cilido person si nxitje ose si shpërblim për realizimin apo për mos bërjen e ndonjë veprimi që lidhet me dhënien e një kontrate apo implementimin e një kontrate që tashmë është nënshkruar me Autoritetin kontraktues.

Neni 43 Dënimet administrative dhe financiare

- 43.1** Pa e paragjykuar zbatimin e dënimeve të parapara në kontratë, Kontraktuesi që është shpallur fajtor për deklaratë të rrejshme ose që është zbuluar se seriozisht nuk ka arritur të plotësojë obligimet e veta kontraktuese në ndonjë procedurë të mëhershme të prokurimit, do të përjashtohet nga të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga buxheti i komunitetit për më së shumti dy vite nga koha kur është përcaktuar se ka pasur shkelje, ndërsa pas konfirmimit pas një procedure gjyqësore kontestimore me Kontraktuesin. Kontraktuesi mund të prezantojë argumentet e veta kundër dënimit brenda [30] ditësh pas njoftimit të dënimit me letër të regjistruar dhe me njoftim të pranimit ose me ndonjë mënyrë apo mjet tjetër ekuivalent. Në mungesë të reagimit nga ana e Kontraktuesit, ose të tërheqjes së dënimit nga OSHP brenda [30] ditësh nga pranimi i argumenteve të Kontraktuesit kundër kësaj, vendimi që e imponon dënimin do të bëhet i zbatueshëm. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në tri vite në rast se shkelja përsëritet brenda pesë vitesh pas shkeljes së parë.

Neni 44 Kontrollat dhe auditimet

- 44.1** Autoriteti kontraktues do t'i lejojë Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës të verifikojë, duke ekzaminuar dokumentet ose përmes kontrolleve të befasishme, implementimin e kontratës dhe të bëjë një auditim të plotë, nëse është i nevojshëm, në bazë të dokumenteve plotësuese për llogaritë, dokumentet e kontabilitetit dhe ndonjë dokument tjetër që është me rëndësi për financimin e kontratës. Këto inspektime mund të bëhen edhe deri në [7 vite] pas pagesës finale.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

PËRMBAJTJA:

Këto kushte përforcojnë dhe plotësojnë, nëse është e nevojshme, Kushtet e përgjithshme që udhëheqin kontratën. Përveç nëse Kushtet e veçanta lejojnë ndryshe, Kushtet e përgjithshme mbeten plotësisht të zbatueshme. Numërimi i neneve të Kushteve të veçanta nuk është konsekuativ por i përmbahet numërimit të neneve në Kushtet e përgjithshme. Në raste të veçanta, dhe me autorizim të departamenteve kompetente të Komisionit, mund të përfshihen edhe klauzola tjera për të mbuluar situata specifike.

Neni 2 Ligji i zbatueshëm

- 2.1 (për kontratat e dhëna sipas LPP-02/L-99), Ligjet në fuqi në Kosovë zbatohen për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës.

- 2.2 Gjuha që përdoret duhet të jetë gjuha e zbatuar në procedurë.

Neni 4 Komunikimet

Komunikimet nga ana e Autoritetit Kontraktues - zyrtarit të prokurimit dhe kontraktuesit do të bëhen me shkrim.

Neni 7 Dorëzimi i dokumenteve

Sipas specifikimeve teknike në dosjen e tenderit

Neni 8 Ndihma me rregulloret lokale

Sipas kushteve të përgjithshme.

Neni 9 Obligimet e Kontraktuesit

Te bej furnizimin me derivate te naftës në bazë të kërkesës ,sipas specifikimit te ofertës

Neni 10 Prejardhja

[Saktësoni ndonjë lejim devijimi nga rregullat e prejardhjes]

Neni 11 Siguria e ekzekutimit

Nuk aplikohet

Neni 12 Sigurimi

[Saktësoni kërkesat specifike të sigurimit]

Neni 13 Programi i realizimit (orari)

Sipas kushteve te kontratës.

Neni 14 Skicat e Kontraktuesit

Sipas specifikimit te ofertës

Neni 15 Çmimet e tenderit

Si në Kushteve të përgjithshme

Neni 17 Patentat dhe licencat

Si në Nenin 17 i Kushteve të përgjithshme

Neni 18 Rendi i fillimit

18.1 Meniher pas neshkrimit te kontratës

Neni 19 Periudha e ekzekutimit

19.1 Kontratë afatgjate përkatatsisht prej dt.30.09.2010 deri me dt.30.09.2011

Neni 22 Variacionet

Autoriteti kontraktues mban të drejtën që, në kohën e kontraktimit, t'i ndryshojë sasi të e specifikuar për sasi të/artikujt e sasive, me numra [.....] brenda një rangu prej [+/- ...%]. Vlera totale e furnizimeve nuk bën të rritet dhe as të bjerë si rezultat i variacionit të sasive për më tepër se 10% të çmimit të kontratës. Çmimet për njësi të përdorura në tender do të jenë të zbatueshme për sasi të e blera nën atë variacion.

Neni 24 Cilësia e furnizimeve

Sipas specifikimit teknik në ofertë .

Neni 25 Inspektimi dhe testimi

Në pkën e liferimit përkatatsisht në Deçan ,mallrat që do të inspektohen dhe testohen në pajtim me Nenin 25 të Kushteve të përgjithshme dhe marrëveshjet praktike për testim]

Neni 26 Metodat e pagesës

26.1 Pagesat duhet të bëhen:

Pas pranimit te furnizimit dhe faturës nga ana e kontraktuesit.

Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendur në paragrafin 26.1 më lart:

Pas pranimit të furnizimeve, faturës nga kontraktuesi pagesa behët në bazë të çmimit të bursës ndërsa Premiumi për njësi (litër derivat) 0.085 €.

26.9 Rishikimi i çmimeve

Nuk aplikohet

Neni 29 Dorëzimi

29.1 Kontraktuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin e përkohshëm në destinacion. Furnizimet duhet të pakëtohen në atë mënyrë që të parandalohet dëmi ose keqësimi i tyre gjatë transportit deri në destinacion.

Neni 31 Pranimi i përkohshëm

Nuk aplikohet

Neni 32 Garancia

Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe në material. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet valide për një vit) pas pranimit të përkohshëm.

Neni 33 Shërbimet pas shitjes

33.4 nuk aplikohen

Neni 35 Shkelja e kontratës

35.3 Rezulton me ndërprerjen e kontratës sipas kushteve të përgjithshme të kontratës

Neni 40 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

40.2 Palët kontraktuese duhet që mosmarrëveshjet së pari ti provojnë ti zgjidhin me pajtim në mënyrë miqësore.[

Neni 41 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

a) Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të cilat mund të shfaqen gjatë realizimit të kësaj kontrate, nëse nuk ka qenë e mundur të zgjidhet në mënyrë tjetër ndërmjet palëve, do t'i dorëzohen <saktësoni gjykatë kompetente > në pajtim me ligjin Kosovar.